


RELACION TEKNIK

Studim projektim për “Mirëmbajtje e Thellë të palestrave në objektet publike”

Shkolla 9 vjecare “Skender Çaçi”



<i>Projektues</i>	<i>Projektues Konstruktore</i>	<i>Subjekti Porosites</i>	<i>Rev.</i>
VENUS CONSULTING sh.p.k	Ing. Kozeta Sheperi	BASHKIA TIRANË	0.00
		Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike	Korrik – Gusht 2025

Permbajta

.....	1
Permbajta	2
1. OBJEKTI I NDËRHYRJES DHE QËLLIMI I PROJEKTIT.....	3
2. VENDNDODHJA DHE GJENDJA EKZISTUESE	3
3. PUNIMET E PARASHIKUARA	6
1.1 Prishje	6
1.2 Shtresë e re sportive	6
1.3 Detaje	7
1.4 Ndriçimi i brendshëm	8
1.5 Mure	8
1.6 Pajisje sportive	8
4. ZBATIMI I STANDARDIT EN 14904 SHITRESEN E DYSHEMESE	8
5. REKOMANDIME PËR MIRËMBAJTJE.....	9
6. PËRFUNDIME.....	9

1. OBJEKTI I NDËRHYRJES DHE QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky relacion teknik i referohet ndërhyrjes për rikonstrukcionin e palestrës së shkollës 9-vjeçare "Skënder Çaçi", në përputhje me detyrën e projektimit të miratuar nga Bashkia Tiranë.

Qëllimi i projektit është përmirësimi i kushteve të zhvillimit të aktiviteteve sportive, rritja e sigurisë, funksionalitetit dhe ndriçimit të ambienteve sportive, në funksion të procesit mësimor dhe përdorimit nga komuniteti.

2. VENDNDODHJA DHE GJENDJA EKZISTUESE

Ky objekt shkollor ndodhet ne Njesine Administrative Nr.8, ne Rr. “E Dibres”, dhe aktualisht gjendjen fizike dhe teknike te palestres e ka tejet te amortizuar. Ky ambient ndodhet në pjesën e pasme te shkolles, me hyrje të veçante dhe në të aktualisht zhvillohet mesimi sportiv me tematika kryesisht te lojrave me dore dhe atletike, por ky mesim kufizohet prej shtresës së dyshemesë tejet te demtuar dhe me aromë të rëndë prej lagështirës.

Ne permbledhje mun te thuhet qe palestra aktuale ka strukturë ekzistuese të amortizuar me mure të dëmtuara, dritare të vjetra, sistem ndriçimi joefikas dhe dysheme të papërshtatshme për aktivitete sportive. Nevojitet ndërhyrje e plotë në infrastrukturën e brendshme për të garantuar sigurinë dhe funksionalitetin e saj.



Figura 1. Vendndodhja e objektit

Nga inspektimi në terren evidentohet:

- Gjendja e terrenit të brendshëm sportiv është e amortizuar kjo edhe sepse materialet që formojnë shtresat sportive janë të një cilësie jo të mire
- Shtresa e poshtme e terrenit është me material plastik, pjesërisht me demtime dhe çarje, e papershtatshme për kryerjen e aktiviteteve sportive mbi të. Kjo sepse paraqitet teper e rrezikshme për rastet kur fëmijet mund të rrezohen mbi të dhe të aksidentohen.
- Ndriçimi i brendshëm është i amortizuar dhe prozhektorët aktualë nuk janë pozicionuar në mënyrë të tillë që të mbulojnë me dritë të gjithë ambientin, duke lënë pjesë të errëta, në rastet e aktiviteteve sportive të mbremjes, në periudhën e dimrit.
- Muret janë të thjeshta, pa elementë mbrojtës ndaj goditjeve apo përthithjes së zërit.
- Pajisjet sportive janë të amortizuara dhe nuk përmbushin kërkesat për zhvillimin e disiplinave të ndryshme.



Figura 2. Gjendja ekzistuese e palestrës



Figura 3. Gjendja ekzistuese e palesetres

3. PUNIMET E PARASHIKUARA


1.1 Prishje

- Largimi i shtresës së vjetër plastike.
- Prishje suvatim muri i brendshem.
- Heqje dyer dhe dritare ekzistuese
- Prishje instalime elektrike

1.2 Shtresë e re sportive

- Aplikimi i një sistemi sportiv me karakteristika për:
 - ✓ Absorbim të goditjes: 25-35%
 - ✓ Rrëshqitje e kontrolluar
 - ✓ Barazi rrotulluese
 - ✓ Rezistencë ndaj topave, ngarkesës statike dhe dinamike

- Detaje shtresash




- Skema perfundimtare e shtresave të dyshemesë:
 - ✓ Shtresë parket 8cm
 - ✓ Shtresë lluster çimento, t=20mm
 - ✓ Shtresë hidroizolim 2 Komponent
 - ✓ Shtresë ekzistuese betoni
 - ✓ Shtrese natyrale

1.3 Detaje

PARKETI DUOBAT 120+


Sistemi DuoBat 120+ ofron maksimumin e performancës dhe sigurisë së larë, së bashku me fleksibilitetin praktikisht të pakufizuar të nivelit për të akomoduar të gjitha llojet e dyshemeve të pabarabarta. Dërrasat e dyshemesë prej druri të trasha 22 mm janë të fiksuara në një sistem nën dysheme që përbëhet nga 2-shtresa të binareve të ndërtuara kryq.

Pjesa sipër konstruksionit te binareve ka jastëk gome. Kjo siguron një lidhje të shpejtë, të saktë dhe të sigurt midis shtresave të sipërme dhe të poshtme.



KOMPONENTET E SISTEMIT

1. Dërrasat e dyshemesë 22 x 129 x 3700 mm
2. Shtresa e sipërme: 25.5 x 60 x 3600 mm me jastëk goditjeje gome
3. Shtresa e poshtme: 39 x 40 x 3364 mm me J-Lock
4. DuoWedge
5. Pengesë Ingëshite PE
6. Skaj i kombinuar sportiv



SPECIFIKIME :	PARKETI DUOBAT 120+
PERDORIMI :	Të gjitha llojet e sporteve Salla sportive shkollore/universitare Nga sportet e rregullt të lojës që luhet në arenat e mëdha
LLOJI :	Dru 1 lloj 1 përkrahës 22 mm me 2 shtresa
KONSTRUKSIONI :	Sistemi me 2 dy shtresa
LARTESIA E KONSTRUKSIONIT :	Nga 120mm-240mm
NGJYRA :	Kafë

Absorbimi i zhurmës
55 < 75%

63%

Deformimi vertikal
3 2.3 < 5.0 mm

2.3 mm

Fërkimi
80 ≤ 110

85 ~

Figura 4. Detaje shtrimi shtresa parket

1.4 Ndriçimi i brendshëm

- Instalimi i ndriçuesve sportivë, të montuar në lartësinë e tavanit, me intensitet të barabartë në të gjithë sipërfaqen.
- Rekomandohet ndriçim minimal 300 lux në zonën aktive, rezistencë ndaj goditjes (IK08) dhe jetëgjatësi >50.000 orë.
- Jane parashikuar te vendosen ndricues projektor me llampe SAP-T 250w

1.5 Mure

- Suvatim muret e brendshme, me llaç M25
- Veshje me panele akustike murale
- Veshje muri me gomine speciale të butë per mbrojtjen e femijeve dhe amortizimin e goditjeve t=42mm H=1.5m
- Lyerje e muratures se brendshme me boje hidroplastike te cilesise se larte

1.6 Pajisje sportive

- Rinovim i pajisjeve për basketboll, volejball dhe futboll të sallës.
- Rinovimi i rrjete Voleibolli (e çmontueshme) bashke me statiket e nevojshem

4. ZBATIMI I STANDARDIT EN 14904 SHITRESEN E DYSHEMESE

Të gjitha shtresat sportive që do të përdoren duhet të jenë të certifikuara sipas EN 14904, i cili përshkruan kërkesat teknike për:

- Sigurinë biomekanike
- Komfortin e lojtarëve
- Vlerat e rrëshqitjes dhe absorbimit të goditjeve
- Lehtësinë e mirëmbajtjes dhe qëndrueshmërinë ndaj konsumit

5. REKOMANDIME PËR MIRËMBAJTJE

- Pastrimi i përditshëm me pajisje jo-gërryese
- Moslejimi i hyrjes me këpucë të papërshtatshme sportive
- Inspektime periodike të ndriçuesve dhe pajisjeve

6. PËRFUNDIME

Zbatimi i ndërhyrjeve të mësipërme do të sjellë një rritje të ndjeshme të cilësisë së aktivitetit sportiv në shkollën "Skënder Çaçi", duke ndikuar drejtpërdrejt në edukimin fizik dhe masivizimin e sportit. Respektimi i standardit EN 14904 garanton siguri, jetëgjatësi dhe performancë të lartë për përdoruesit e palestrës.